



MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

Nr. 123/1 prot.

Tiranë, më 28.02.2023

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 7, datë 28.02.2023

PËR  
“NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MONITORIMIN E SJELLJES SË  
NËPUNËSVE CIVILË GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”

Në mbështetje, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr. 11, datë 10.02.2023, “Për unifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të tyre politike e detyrimeve ligjore; ndërveprimin e nëpunësve civilë me “Platformat” apo “Rrjetet sociale” që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale; si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën.”

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civil gjatë fushatës zgjedhore me këtë përbërje:
  - Jonida Boci, Zëvendëstitullar/Përgjegjës I Departamentit të Shëndetit të Kafshëve, Kryetar.
  - Brulinda Çobaj, Drejtor Drejtorie Shërbimeve të Brendshme, Anëtar.
  - Denada Telo, Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimi të Cilësisë, Anëtar.
2. Koordinatorin e grupit që do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces, si dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të jetë Znj. Brulinda Çobaj, Drejtore Drejtorie Shërbimet e Brendshme.
3. Grupi i monitorimit të hartojë deri në datë **01.03.2023** rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregullime specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën do ta paraqes për miratim te Titullari I Institucionit.



4. Me këtë urdhër dhe rregulloren e brendshme të grupit të punës, të njihen të gjithë nëpunësit civilë dhe të informohet Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil brenda datës **01.03.2023**, duke i vënë në dispozicion një kopje të praktikës.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohen për zbatim Grupi i Punës dhe Zyra e Protokollit.

**I NGARKUAR ME DETYRËN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM  
PËLLUMB ALEKSI**

